

DIANA DJALOSHI

EMËRTIMET TOGFJALËSHORE NË LEKSIKUN E GJUHËS
STANDARDE SHQIPE TË KOHËS SONË¹

Zhvillimet e mëdha evolucionare në shoqërinë shqiptare, në mënyrë të veçantë këta dhjetëvjeçarët e fundit, qysh pas fillimit të gjysmës së dytë të shekullit XX-të e deri sot, të lidhura me shfaqjen e koncepteve të shumta në të gjitha fushat e jetës shoqërore, kanë çuar në pasurimin dhe zgjerimin e fondit leksikor të gjuhës standarde si edhe në ndryshime brenda tij në marrëdhëniet ndërmjet shtresave të fondit të njësive emërtuese dhe të llojeve të tyre. Kështu, krahas shtimit të fondit të fjalëve të krijuara me brumin leksikor dhe mjete fjalëformuese shqipe, sidomos vitet e fundit, si: *bashkëvuajtës*, *bashkëjetues*, *bashkëpronar* etj., është krijuar dhe një fond leksikor me fjalët e huaja, sidomos me burim nga anglishtja, çka ka bërë që, ndryshe nga më parë, para vitit 1990, anglicizmat të krijojnë një shtresë të mëvetësuar si dikur italianizmat, por më të gjerë se ato².

Një pjesë e madhe e tyre janë futur në fushat e reja të dijes, si në informatikë, telekomunikacion, gjenetikë: si p.sh. *maus* (*mouse*), *çatoj* (*chat*), *monitor* etj. Këto përpjesëtime të reja në shtresat leksikore të gjuhës, ku vihet re **pakësimi i formimeve në nivel fjalësh me mjetet e brendshme të gjuhës shqipe dhe shtimi i formimeve me burim nga gjuhët e huaja, kryesisht nga anglishtja**, bëjnë që vetë gjuha, në rrafshin leksikor, të aktivizojë në përmasa më të mëdha, përmes përdoruesve të saj edhe mjete të tjera, të cilat bëhen të domosdoshme në fazën e sotme të rritjes së nivelit intelektual të gjuhës, të intelektualizmit të leksikut të saj, siç janë emërtimet togfjalëshore që shfaqen si njësi emërtuese më të diferencueshme e më të përpikta se fjalët.

Kështu sot takohen shpesh në ligjërimin e shkruar e të folur, madje deri në thjeshtë ligjërim si: *para të pista*, *bono thesari*, *kartë identiteti*, *kartë krediti*, të cilat dallohen për kompaktësinë e tyre semantike, meqë si njësi emërtuese shënojnë koncepte të lidhura me objekte të identifikuar, të përafërta me fjalët, dhe, si të tilla, shërbejnë si emërtime njësoj si fjalët. Vështruar nga kjo pikëpamje, siç është nënvizuar me të drejtë, ndonëse nga ana e formës ato janë struktura të hapura, si tek tipi *kartë identiteti*, kompaktësia e tyre kuptimore

¹ Kjo kumtesë është mbajtur në Konferencën *Kërkime gjuhësore II* mbajtur më 4 korrik 2013.

² H. Shehu, *Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe*, në përmbledhjen "Seminar ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", 19, Prishtinë, 2001.

bën që tek to të mbizotërojë “e tëra mbi pjesët”³ dhe nga ana e funksionit që kryejnë, d.m.th., si emërtime, të ndihen si fjalët.

Këto njësi, që nga forma janë më të gjëra se fjalët, por që funksionojnë si emërtime njësoj si ato, janë përdorur prej kohësh në gjuhë, ndonëse në masë të pa konsiderueshme, por që sasia e tyre është shtuar me vërshimin në këto dhjetëvjeçarët e fundit të koncepteve të reja, të papërballueshme për t’u emërtuar nga fjalët. Kështu sot mund të takohen togfjalësha të tillë të krijuar para disa dekadash, si formime për zëvendësimin e fjalëve të huaja: *goditje nga këndi* (për *korner*), *makinë larëse* (për *lavatriçe*), *makinë llogaritëse* (për *kalkulatriçe*) etj.

Nga pikëpamja e prejardhjes së tyre këto njësi kanë gjalluar në gjuhë qysh në kohët e hershme; aty këtu janë evidentuar në fjalorë, ku gjejmë të tilla qysh tek Fjalori i F. Bardhit⁴: *gisht i vogël, gisht i madh, thi i egër, ujë i ëmbël, ujë i gjelbër = ujë i kripur, vesh rrushi* etj. Duhet nënvizuar se prej ndonjë studiuesi, disa prej tyre janë cilësuar edhe si kompozita, siç janë konceptuar të tilla: *ve pate, pulë deti*⁵ etj. Në mënyrë të veçantë, ato kanë gjetur pasqyrim të gjerë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980, ku vihet re aktivizimi i njësisve të përbëra me elemente përcaktuese: *popullor, socialist, klasor*, dhe të përcaktuara si: *parti, klasë, organizatë*. Kështu M. Samara⁶ sjell me elementin përcaktues *popullor* rreth 80 togfjalësha. Lidhur me funksionimin dhe përdorimin e tyre si njësi emërtuese në terminologjinë e fushave të ndryshme të dijes, ka një varg punimesh nga terminologë nga Shqipëria si H. Pasha⁷, A. Duro⁸, nga Kosova A. Spahiu⁹, F. Çitaku dhe të huaj M. Popova¹⁰ etj., të cilët i kanë vështruar këto njësi nga ana strukturore, semantike dhe në lidhje me togfjalësha të tjerë të lirë, frazeologjikë, si dhe në raport me fjalën.

Me interes do të ishte vështrimi i këtyre kategorive në dy faza të përdorimit të tyre në gjuhë, siç është faza para vitit 1990 dhe pas vitit 1990, që përkojnë në rastin e pare, me periudhën e mbyllur të shoqërisë shqiptare totalitare dhe pas vitit 1990, me periudhën e hapjes së Shqipërisë me botën, ku

³ H. Pasha, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, *Studime Filologjike*, 1986/3.

⁴ E. Sedaj, *Fjalor latinisht –shqip i Frang Bardhit (1635)*, Prishtinë, 1983.

⁵ K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.

⁶ M. Samara, *Mbi leksikon politiko-shoqëror të shqipes dhe mbi zhvillimin e tij pas Çlirimit*, “Studime mbi leksikologjinë”, 2, 1972.

⁷ H. Pasha, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, “Studime Filologjike”, 1986/3.

⁸ A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, “Studime filologjike”, 1982/4.

⁹ A. Spahiu, *Mbi disa terma të pathjeshtë të shqipes*, në “Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi”, Prishtinë, 1988.

¹⁰ M. Popova, *Terminisllivosoçetaniya*, Bollgarska akademija, Sofija, 1985.

Emërtimet togfjalëshore në leksikon e gjuhës standarde shqipe të kohës...

zhvillimet janë më intensive. Meqenëse ndryshimet e shoqërisë shqiptare kanë qenë shumë intensive pas vitit 1990, këtu do të përqendrohemi kryesisht në këto vite. Lidhur me përdorimin e togfjalëshave pas vitit 1990, krahasuar me emërtime ekzistuese para kësaj kohe, mund të vërehen shfaqjet e mëposhtme:

1. Dalja nga përdorimi, sidomos të togjeve me ngarkesë të theksuar politike që shprehin dukuri specifike të shoqërisë totalitare: *luftë klasash, kooperativë bujqësore e tipit të lartë, pushtet popullor, demokraci popullore* etj.

2. Hyrja në përdorim e emërtimeve të reja si zëvendësuese të emërtimeve të shoqërisë totalitare si: *bashki e qytetit ← komitet ekzekutiv; selia e partisë ← komiteti i partisë, shtet pluralist ← shtet i diktaturës së proletariatit, kryesi e partisë ← byro politike (Byro Politike)*.

3. Hyrja në përdorim e emërtimeve që shënojnë koncepte të reja të ndërtuara kryesisht mbi bazën e fjalëve ekzistuese në gjuhë më rrallë edhe të fjalëve të reja, ku si elemente të përcaktuara përdoren *komunitet, bashki, seli, bashkësi*, etj., por duke krijuar lidhje të reja: *koalicion shumëpartiak, organizatë joqeveritare, mjedis homofibik, treg i brendshëm, bord ekzekutiv, bashkësi shumëkombëshe, trupa të ndërhyrjes së shpejtë* etj.

Togfjalëshat e qëndrueshëm nuk janë njësi **leksiko-gramatikore**, meqenëse ata, ndryshe nga fjala përbëjnë struktura të hapura. Si të tilla nuk përbëjnë njësi leksikore të plota më vete, por futen në **strukturën semantike në fjalorët shpjegues**, shfaqen si njësi leksiko-sintaksore dhe mund të pranohen si leksik plotësues i gjuhës. “Përhapja e gjerë e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhë si njësi emërtuese të veçanta leksiko-sintaksore krijon një shtresë të veçantë në rrethin e leksikut terminologjik, e cila karakterizohet nga veçori e veti të caktuara specifike që kërkon analiza të hollësishme sidomos të elementit të përcaktuar të togfjalëshit, meqenëse ai mbart ngarkesën kryesore semantike të togfjalëshit.”¹¹

Një ndër problemet e rëndësishme që lidhen me funksionimin dhe përdorimin e emërtimeve togfjalëshore në kohën e sotme është raporti i marrëdhënieve ndërmjet elementit të përcaktuar dhe elementit përcaktues. Ngaqë elementi përcaktues ndikon mbi elementin e përcaktuar në diferencimin dhe identifikimin kuptimor, si, p.sh. *revistë mode* (1) dhe *revistë shkencore* (2), ku gjymtyrët përcaktuese të njësive togfjalëshore të dhëna “*mode*” dhe “*shkencore*” diferencojnë dhe identifikojnë dy tipe të ndryshme reviste (si elemente të përcaktuara) tek (1) “lloj reviste me karakter zbavitës, ilustruese-figurative” dhe (2) “lloj reviste me karakter studimor” dhe kështu në të dyja rastet kemi të bëjmë me dy koncepte të ndryshme të lidhura me dy objekte të dallueshme nga njëri-tjetri. Ky diferencim mund të vërehet edhe tek dallimi i

¹¹A. Duro, *Terminologjia si sistem*, “Panteon”, 2001.

tyre konceptor në anglisht, ku për secilin koncept përdorën dy emërtime të ndryshme: *magazine* dhe *journal* ku në shqipe i përgjigjen një fjale: *revistë*. Në këto emërtime rëndësi specifikuere merr elementi përcaktues, i cili e diferencon dhe e identifikon elementin e përcaktuar, duke shërbyer kështu si bazë për diferencimin e kuptimit të njësisë, siç del edhe nga “*jofitimprurëse*” tek *organizatë jofitimprurëse* dhe “*partiak*” tek *organizatë partiake*. Në këtë rast është pikërisht elementi përcaktues që e specifikon kuptimin e njësisë së përcaktuar “*organizatë*”, ku bëhet fjalë për një koncept të ri që “lidhet me një mënyrë organizimi dhe veprimtarie që nuk sjell fitim për anëtarët e saj, por mbron të drejtat e një grupi të caktuar të shoqërisë”.

Ndonëse emërtimet togfjalëshore janë njësi emërtuese që funksionojnë si fjalët, ngjizja e elementeve përbërëse nuk është e një kategorie. Ka togfjalësha me marrëdhënie të lira dhe togfjalësha me lidhje të qëndrueshme deri idiomatike dhe si të tillë afrohen me njësitë frazeologjike. Në rastin e fundit të dy elementet e togfjalëshit kanë shkallë të lartë figurshmërie: *princ i kaltër*, *libër i bardhë*, *rrjedhje truri* etj. Veç kësaj nga lidhjet e tyre mund të shkohet në diferencimin dhe identifikimin e kuptimeve të veçanta, që kanë elementet e përcaktuar në varësi nga elementet përcaktuese. Sa më i saktësuar kuptimisht të jetë elementi i përcaktuar aq më lehtë mund të mëvetësohet ai si element si p.sh. *Akademi* tek “*Akademia e Shkencave*”, *Departament* tek “*Departamenti i Shtetit*” etj.

Vështruar nga kjo anë mund të dallohen në këta togfjalësha katër lloje lidhjesh në varësi të elementeve përbërëse:

1. Të dy elementet janë konkrete dhe lidhja është e qëndrueshme, por, gjithsesi, kjo qëndrueshmëri është e dobët si tek: *organizatë fitimprurëse*, *organizatë jofitimprurëse*. Kuptimi i secilit element *organizatë* (i përcaktuar) dhe *fitimprurëse* (përcaktues) kanë kuptim pak a shumë konkret. Siç mund të dalë nga ngjizja e dy elementeve të njësisë togfjalëshore, kuptimi (koncepti rezultat¹²) që rrjedh nga kombinimi i të dy elementeve (*organizatë + jofitimprurëse = organizatë jofitimprurëse*) shpreh një koncept të përgjithshëm. Megjithatë koncepti rezultat, i shprehur nga e gjithë njësia mund të shënojë edhe një koncept të përveçëm, të lidhur me një objekt të vetëm, si, p.sh. tek “*Prokuroria e Përgjithshme*”, “*Kuvendi Popullor*”. Në këtë rast njësia del e përbërë nga dy elemente që shënojnë shkallën më të lartë të konkretësisë konceptuale çka pasqyrohet sidomos tek elementi i përcaktuar, si tek *Prokurori* dhe *Kuvendi*, ku tek togfjalëshat të dyja elementet shkruhen me shkronjë nistore të madhe. Këto raste mund të shikohen edhe si kalime nga emërtimi i përgjithshëm në të përveçëm, ku emërtimi i parë i referohet një koncepti të përgjithshëm, si të thuash i lidhur me shumë objekte, si, p.sh.,

¹² M. E. Wüster, *Das Worten der Welt, schaubildlich und terminologisch* në “*Sprachforum*”, (Bonn), 3, 1959/1960.

Emërtimet togfjalëshore në leksikon e gjuhës standarde shqipe të kohës...

avokat i popullit “çdo person që e kryen këtë funksion” dhe *Avokati i Popullit* “një person i caktuar” siç është i tillë një person i vetëm në vendin tonë. Këto kalime mund të shihen edhe tek *prokuror i përgjithshëm* → *Prokurori i Përgjithshëm*, *komision i ligjeve* → *Komisioni i Ligjeve*, ku si tipari theksuar tek të dytat vihet re shquarsia e elementit të përcaktuar (*Komisioni*, *Prokurori*) dhe shkrimi i të dy elementeve me shkronjë nistore të madhe.

2. Njëri nga elementet (i përcaktuar) është i konotuar, ka një kuptim të figurshëm, të përbërë nga një metaforë a metonimi dhe tjetri është konkret: *pushteti i katërt* (pushtet = media), *libër i bardhë* (libër = dokument ligjor), *shoqëri civile* (shoqëri = bashkësi) etj.

3. Elementet kanë shkallë të ndryshme figurshmërie në lidhjen e tyre me njëri tjetrin: *kapje shteti* me kuptimin “arritje e qëllimeve me çdo mjet për shkak të korrupsionit”, *para të pista* me kuptimin “para të fituara në mënyrë të paligjshme”, *rrjedhje truri* me kuptimin “ikje intelektualësh jashtë vendit”, *larje parash* me kuptimin “ligjësim i parave të fituara në mënyrë të paligjshme nëpërmjet praktikave ekonomike”.

4. Të dy elementet janë të figurshme dhe, në këtë rast, siç e theksuam më lart, këta togfjalësha janë të afërt me njësitë frazeologjike si: *larje hesapësh*, *larje truri*, *mish i bardhë*; tek ky i fundit në kuptimin “element femër që trajtohet njëlloj si “mish special” që shfrytëzohet për qëllime fitimi”. Megjithatë në raste të caktuara vihen re kalime nga njëri grup te tjetri kështu që ky dallim nuk duhet parë në mënyrë të prerë, si p.sh. *kapje shteti* dhe *larje truri*, *mish i bardhë* dhe *libër i bardhë*.

Megjithatë mund të vihet re që togfjalëshi mund të përbëhet nga më shumë se dy elemente, çka bën që të ketë dallime në shkallën e diferencimit të tij në raport me togfjalësha të tjerë me më pak gjymtyrë. Nëse togfjalëshi i thjeshtë përbëhet nga dy elemente, togfjalëshi i zgjeruar përbëhet nga më shumë se dy elemente. Kështu “*organizatë jofitimprurëse*” zgjerohet në “*organizatë jofitimprurëse me anëtarësi*”. Sa më shumë elemente të ketë togfjalëshi, aq më e dobët është lidhja e elementeve, edhe pse kjo lidhje mbetet përsëri e qëndrueshme. Në këtë rast emërtimet togfjalëshore në lidhje njëri me tjetrin, të ndërtuar në bazë të një elementi të përcaktuar të përbashkët përbëjnë një farë mikrosistemi ku si bazë togfjalëshformuese shërben elementi i përcaktuar, si, p.sh. *organizatë jofitimprurëse* → *organizatë jofitimprurëse* → *organizatë jofitimprurëse me anëtarësi* etj. Nga ana tjetër, sa më i papërcaktuar kuptimisht të jetë elementi i përcaktuar, aq mëme vështirësi mëvetësohet ai si njësi e mëvetësuarsi: *Akademi e parukerisë*, *Akademi përkujtimore*. Po kështu mund të krahasohen: *presidenti i vendit*, ku veçimi është më i mundur dhe *presidenti i kompanisë* ku është më e vështirë të bëhet mëvetësimi i tij. Megjithatë në lidhje me shkallën e qëndrueshmërisë së togfjalëshit ndikon edhe ana kuptimore e vetë elementit të përcaktuar ose

përcaktues. Karakteri i lidhjes së elementit të përcaktuar me atë përcaktues duhet vështruar edhe nga pikëpamja e aftësive diferencuese dhe identifikuese që i bëhet kuptimit të togfjalëshit në tërësi dhe sidomos elementit të përcaktuar nga përcaktuesi kur zgjerohet struktura e togfjalëshit. Kjo e fundit çon, në pjesën më të madhe të rasteve, në diferencimin e kuptimeve (të koncepteve) të elementit të përcaktuar. Kështu, nëse “*organizatë*” është një fjalë që ka një kuptim të caktuar, elementi “*jofitimprurës*” e specifikon atë dhe i jep nuancë të re kuptimore. Nëse ne e zgjerojmë edhe më shumë këtë togfjalësh në “*Organizatë jofitimprurëse me anëtarësi*” atëherë si pjesë e përcaktuar del togfjalëshi “*organizatë jofitimprurëse*”, kurse si element përcaktues shërben “*me anëtarësi*”, i cili e diferencon më tej kuptimin e togfjalëshit të zgjeruar të mësipërm.

Rastet e veçimit të elementit të përcaktuar mund të karakterizohen nga një varg shfaqjesh, si edhe mund të kushtëzohen nga faktorë të ndryshëm:

1. Elementi i përcaktuar mund të veçohet gjatë përdorimit nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm jashtëgjuhësorë:

- Faktori kohor që lidhet me përdorimin e togfjalëshit për një kohë shumë të gjatë krahas me elementin e përcaktuar si të veçuar prej tij. Në këtë rast togfjalëshi mund të përfaqësohet vetëm nga elementi i përcaktuar, duke mbuluar edhe kuptimin e elementit përcaktues si *Kuvend Popullor* → *Kuvend, Akademia e Shkencave* → *Akademi*.

- Faktori i përdorimit shumë të specializuar nga një grup i kufizuar personash si p.sh.: *bordi i kompanisë* dhe *bordi*; Përdoruesit e kanë kaq të njohur togfjalëshin sa të gjithë e kuptojnë se cilit po i referohen, edhe nëse përdorin vetëm elementin e përcaktuar.

- Faktori i përdorimit të kufizuar tekstual a kontekstual që shërben si kriter që mundëson përdorimin e mëvetësuar të tij. Kështu në kopjet e një teksti “*Komision*” do të thotë “*Komision i Ligjeve*”, “*Këshill*” do të thotë “*Këshill Bashkiak*” etj.

2. Elementi i përcaktuar veçohet në një shkallë të ndërmjetme: Kur përdoruesi sipas rastit e ndjen ose nuk e ndjen nevojën e elementit përcaktues si p.sh. *Presidenti i Republikës* dhe *Presidenti*; *Kryetari i grupit parlamentar* dhe *Kryetari*.

3. Elementi i përcaktuar s’ka mundësi veçimi dhe gjithë njësia merr kështu formën e lidhjes idiomatike, të përafërt me një njësi frazeologjike: Përdorimi në nivel idiomatik ndodh edhe kur elementi i përcaktuar shfaqet në kufij të paqartë kuptimorë ndihet nevoja e domosdoshme e përdorimit të elementit përcaktues. Kjo do të thotë që po të përdoret vetëm “*kapje*” dhe jo “*kapje e shtetit*” nuk del kuptimi; e njëjta logjikë ndiqet edhe për togfjalëshat *pushteti i katërt, para të pista, larje parash* ku po të përdoren vetëm “*pushteti*”, “*para*” apo “*larje*” nuk del kuptimi. Disa fjalë si: *kapje, marrje, shfrytëzim, goditje* etj., janë emra foljorë të papërcaktuar që e marrin kuptimin

Emërtimet togfjalëshore në leksikon e gjuhës standarde shqipe të kohës...

kur bashkohen me një fjalë përcaktuese në togfjalësh. Lidhjet pak a shumë idiomatike nuk janë gjithmonë të kuptueshme për individët jashtë profesionit, si, p.sh.: *kapje e shtetit, taksë mbi vlerën e shtuar, shfrytëzim i pozicionit të punës*, nuk janë të kuptueshme për personat që janë jashtë sferës së përdorimit. Disa lidhje bëhen aq të afërta sa përbëjnë një të tërë unike. Sa më i papërcaktuar të jetë kuptimi i gjymtyrës, aq më shumë ndihet nevoja e togfjalëshave. Tek këta togfjalësha del nevoja e përkufizimit të tyre, meqë ata bëjnë pjesë në kompetencën gjuhësore dhe kulturore të specialistëve. Këtu duhet nënvizuar përdorimi i këtyre togfjalëshave me ngjizje të elementeve përbërëse që vihet re në ato raste kur specialistët janë përdoruesit e drejtpërdrejtë të tyre, sidomos kur ato zëvendësojnë me to fjalët e huaja. Kjo vjen jo vetëm për shkak të mungesës së termave barasvlerës njëfjalësh shqip, por edhe për shkak të përpjekjes së specialistëve për të gjetur një barasvlerës shqip qoftë edhe togfjalësh, i cili përdoret krahas termit të huaj më tepër për ta sqaruar atë. Në të njëjtën kohë futja e emërtimeve togfjalëshore përbën një akt pozitiv, meqë çon në pasurimin e gjuhës me njësi e modele të reja togfjalëshformuese si: *stakeholders* → *grupe interesi*, *feedback* → *informacion i kthyeshëm*, *outreach community* → *të përfshish komunitetin*, *empowerment of women* → *fuqizim i gruas*), *enabling the followers* → *aftësim i pasuesve*, etj. Këta togfjalësha përdorën shpesh krahas fjalëve të huaja jo vetëm në sektorin e shoqërisë civile, por edhe në sektorin publik.

Togfjalëshat si njësi emërtuese të drejtpërdrejta kanë gjetur terren për të përcjellë në mënyrë të saktë konceptet e reja. Fjalëve ekzistuese të leksikut të gjuhës shqipe, krahas atyre që janë përdorur më parë, u janë shtuar fjalë të tjera, duke u bërë bazë për togfjalësha që transmetojnë mendësi dhe koncepte të reja. Si rezultat i ndikimit të modeleve që ekzistojnë në gjuhë vihen re zhvillime të mëtejshme të togfjalëshave të caktuar, të cilat shndërrohen në njësi më kompakte, në fjalë. Kjo vërehet në ndërtimin mbi bazën e togfjalëshave të një vargu kompozitash, të cilat me përbërjen e tyre shprehin një shkallë abstraksioni më të lartë, çka çon në integrimin e tyre në fondin e leksikut të gjuhës, sepse ato kalojnë kështu nga një leksik plotësues në leksik me të drejta të plota, siç mund të shihen tek *marrje vendimi* → *vendimmarrje*, *pagim taksash* → *taksapagim* etj. Në të njëjtën mënyrë mund të ndërtohet kompozita “*shtetkapje*”: ngjizja (*kapje e shtetit* → *shtetkapje*); vihet re gjithashtu zhvillim i mëtejshëm fjalëformues dhe togfjalëshformues: *shtetkapës* → *kompani shtetkapëse*, *fuqi shtetkapëse*; *pozicion shtetkapës* etj. Po kështu nga *gjithëpërfshirje* → *gjithëpërfshirës* → *planifikim gjithëpërfshirës*, *nismë gjithëpërfshirëse* etj.

Duke analizuar më tej emërtimet togfjalëshore vihet re se ndërmjet gjymtyrës së përcaktuar dhe asaj përcaktuese vendoset një marrëdhënie e tillë ku gjymtyra përcaktuese, si diferencuese dhe identifikuese e kuptimit të asaj të

përcaktuar, mund të shërbejë si element përmyllës i konceptit rezultat të shprehur në tërësi nga i gjithë togfjalëshi përmes gjithë gjymtyrëve të tij përbërës në kombinim me një tjetër si: *organizatë + jofitimprurëse* → *organizatë jofitimprurëse dhe organizatë + jofitimprurëse + me anëtarësi* → *organizatë jofitimprurëse me anëtarësi*. Kjo do të thotë se përmbajtja konceptore e çdo emërtimi togfjalëshor, d.m.th. çdo koncept (rezultant) i shprehur prej tij mund të nxirret nga shuma e kuptimeve, të shënuar nga secila gjymtyrë e togfjalëshit dhe në këtë rast çdo koncept rezultat shërben si bazë për të lidhur në mikrosistem togfjalëshat, ku si bazë lidhëse e tyre shërben elementi i përcaktuar i përbashkët për të gjithë togfjalëshat në mikrosistem. Pra, krahas çdo emërtimi togfjalëshor mund të nxirret përmbajtja konceptore e tij: pak a shumë, ndryshimi për secilin prej tyre, por e përbashkët për shkak të gjymtyrës që i lidh ato në mikrosistem. Nga shembujt që do të jepen më poshtë mund të vihet re se edhe elementi përcaktues, ndonëse i ndryshëm për disa togfjalësha mund të shërbejë si bazë për t'i lidhur dy ose më shumë togfjalësha rreth një përmbajtje shumë të afërt konceptore ose deri si sinonime absolute, krahas rasteve kur përmbajtja konceptore mund të diferencohet më shumë.

a) Rasti i një përmbajtjeje konceptore shumë të përafërt:

- *akademi jubilarë* – koncepti 1

- *akademi përkujtimore* – koncepti 2

Konceptet 1 dhe 2 kanë përmbajtje të përafërt konceptore “Tubim studiuesish për një ngjarje të caktuar”.

b) Rasti i përmbajtjes së diferencuar:

- *akademi ushtarake* - koncepti 1 “Institucion i lartë mësimor”

- *akademi e parukerisë* - koncepti 2 “Shkollë e specializuar që përgatit parukiere me nivel të lartë profesional”.

c) Rasti i një përmbajtjeje të njëjtë si shfaqje të sinonimisë absolute, e cila mund të çojë në sinonime togfjalëshash, ndonjëherë të huaj ose vendës:

Lidhje e kundërt = informacion i kthyeshëm = prapaveprim = feedback;

Grupe interesi = grupe ndikuese = pretendentë = stakeholders.

Çdo koncept i shprehur nga gjymtyra e përcaktuar mund të shërbejë si koncept kyç rreth të cilit bashkohen koncepte të shprehura nga togfjalëshat. Në këtë mënyrë krijohen mikrosisteme ndërkonceptore mbi bazën e elementit të përcaktuar të njëjtë dhe elementeve përcaktuese të ndryshme, ku nga një varg emërtimesh togfjalëshore mund të shkohet deri në shprehjen e koncepteve të përveçme; në disa raste është vështirë të zbulohet koncepti i saktë i shprehur nga gjymtyra e përcaktuar, e specializuar nga gjymtyra përcaktuese siç mund të vërehet tek *akademi*, ku përfshihen si emërtime togfjalëshore të përgjithshme, ashtu edhe të përveçme.

Përfundime

Emërtimet togfjalëshore në leksikon e gjuhës standarde shqipe të kohës...

Si përfundim mund të theksojmë se emërtimet togfjalëshore si leksik plotësues duhet të bëhen objekt studimi të mëtejshëm, ku të vështrohet depërtimi i tyre në fusha të ndryshme të jetës së shoqërisë së sotme (politike, ideologjike, ekonomike) si edhe në të gjitha nivelet e ligjërimit. Lidhur me përfaqësimin e tyre në fjalorët shpjegues të gjuhës, mund të evidentohen njësitë më të përdorshme nga përdoruesit e gjuhës duke dhënë edhe përkufizimet për njësi të tilla si: *rrjedhje truri, para të pista, pushtet i katërt* etj. Mendojmë që të shihet mundësia që, edhe një pjesë togfjalëshash të qëndrueshëm (togfjalësha të tipit që trajtuam), duke u mbështetur në vlerën e tyre të përdorimit, si edhe në vlera funksionale të tilla si shpeshtësia e përdorimit në gjuhë, kompaktësia konceptore, të pasqyrohen si njësi më vete në një fjalor të tipit të madh. Për motivimin e futjes së tyre në Fjalor të tipit të madh autorët mund të mbështeten edhe në fjalorët e gjuhëve të huaja, në të cilët janë përfshirë këto njësi emërtuese të hapura (sipas Webster “open words = fjalë të hapura” të tipit *booking office, filmstar* etj., ku jepen si një fjalë e vetme *bedroom dhe bed room, moviestar and movie star, si në shqipe të një natyre të tillë, si luledele dhe lule dele* etj.

